

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EJA LOYALITY ” sh.p.k

Neni 1

Themelimi

Shoqëria “EJA LOYALITY ” sh.p.k themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” me ortakët:

Z. Erkan Guri madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr.karte identiteti. **I70608007T** lindur në Tiranë, me ditëlindje **08/06/1987** dhe banues në Tiranë Shqipëri.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Shoqëria “ EJA LOYALITY ” sh.p.k themelohet më datë **16/05/2023**

Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, qendër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

Neni 2

Forma e shoqërisë

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakëve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

Neni 3

Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë është “EJA LOYALITY” sh.p.k.

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k.

Neni 4

Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës , në adresën: **Rruga Bogdaneve ,Godina nr.505 , Hyrja 2, AP.29 , Njësia bashkiake nr. 7 , Tiranë**. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakëve të vet, gjithashtu rast pas rasti ajo mund të krijojë ose anullojë seli dytësore administrative, drejtori, filial, degë, agjensi dhe zyra, brenda ose jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

Objekti: Shoqëria ka për objekt realizimin e aktiviteteve të mëposhtme në sektorin publik dhe privat: Përpunim të dhënash për Shërbim Telemarketing. Import eksport dhe tregëtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimor, industriale, elektro-shtepiake, karburante.

Zhvillimi i aktivitetit të hoteleri turizmit, agjensi turistike, transport mallrash dhe pasagjeresh. Kryerjen e aktiviteteve, publikimi, reklamimi, shitje, blerje on-line. Organizim dhe menaxhim, konferencash, evente, seminare, trajnime etj. Shërbime të përkthimit. Pajisje përkthimi, mikrofoni, sisteme audio vizuale. Shërbime katering. Printime, kancelari. Makina me qera, transport me automjete dhe me shoferë, asistencë profesionale për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të tjera në fushën e biznesit, kulturës, sportit, mjekësisë, në fushën e IT, ndërmjetesimi në fushën e biznesit, menaxhim i bizneseve dhe dhënie konsulence për kompani biznesi, ndërmjetesimi etj. Pagesë e shërbimeve me para në dorë, me xhirim bankar, me kartë krediti etj. Shërbime konsulence, menaxhim hotelerie, shërbim këmbim parash. Shërbime ndërmjetesimi tregtare, agjent tregtar etj. Botime të ndryshme përfshirë revista, gazeta, fletpalosje, printime të ndryshme, reklama, banner sticker, auditime, konsulencë e trajnim të gazetareve, operatoreve, fotoreportereve në fushën e medias elektronike dhe asaj të printuar. Auditime e trajnime për gazetarinë multimediale për krijimin e website. Kryerje komisioni për llogari apo në emer të shoqërive të tjera që kanë interes për këto lloje shërbimesh. Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari tjetër tregtare të lejueshme që është e nevojshme dhe e dobishme për të përbushur objektin e saj. Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqëse, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri. Punësime brenda dhe jashtë Shqipërisë. Agjensi ndërmjetesimi në punësim, Agjensi Marketingu, Konsulencë në rekrutimin e punonjësve. Shoqëria do të kryejë të gjitha aktivitetet e mësipërme, si edhe cdo aktivitet tjetër tregtar që nuk është i ndaluar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në QKR, Tiranë.

Me vendim të ortakeve, shoqëria mund vendosë kufizim kohor në veprimtarinë e saj ose ta mbyllë veprimtarinë e saj kur e shoh të arsyeshme, apo janë rastet e parashikuara nga ligji.

KAPITALI THEMELTAR; KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Neni 7

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar është fiksuar në vlerën 100.000 lekë të reja. .

Ortaku i shoqërisë zoteron (1) kuote të shoqërisë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- ✓ Ortaku themelues Z. Erkan Guri : zotëruar i 1 (një) kuote e barabartë kjo me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë (njqind mijë lekë) që përbën 100 (njqind) % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë.

Kapitali mund të zmadhohet dhe të zvogëlohet me vendim të ortakeve.

Neni 8

Kuotat, fitimi dhe kalimi i tyre

Kuotat e pjesëmarrjes janë në zotërim të:

- ✓ Ortaku themelues Z. Erkan Guri : zotërues i 1 (një) kuote e barabartë kjo me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë (njqind mijë lekë) që përbën 100 (njqind) % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë.

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të behët në përputhje me nenet 72- 75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

Neni 9

Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të trasferueshme edhe në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të secilit ortak themelues, në persona të tjerë jo ortakë të shoqërisë do të bëhet vetëm me miratimin e vendimit te asamblese se ortakeve.

Ortakët e kësaj shoqërie, mund të vendosë të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e sheh të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 10

Të drejtat dhe detyrat

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe c, të kzsaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve ;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e përdorimit.
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 11

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

Neni 12

Përfaqësimi në Asamble

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi përfaqësimi noterial nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve në këtë statut.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 14

Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur ky statut parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut ose në ligj për çështjet e tjera, Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Emërimi dhe/ose shkarkimi i administratorëve dhe ekspertit kontabël dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre do të behet sipas ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare.”

Asambleja e Përgjithshme për çështjet e mëposhtme vendos me votën pro të ortakeve që perfasiojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë :

- Miratimi i bilancit.
- Shpërndarja e dividendeve.
- Emërimi dhe shkarkimi i personit që do të merret me kontabilitetin e shoqërisë
- Miratimin i buxhetit vjetor.
- Autorizimin për nënshkrimin e çfardolloy kontrate.
- Miratimi i kërkesës për përjashtimin e njërit prej ortakëve .
- Ndryshimet e statutit.
- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.
- Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë.
- Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Neni 15

E drejta e votës

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimi, përfshirë mjetet elektronike.

Mjetet elektronike të lejuara janë:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i ketyre mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike.

Ortakët kanë të drejtën, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që marrëveshja të bëhet me shkrim.

Neni 16

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 17

Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të ketyre procesverbaleve.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 18

Hetimet e posaçme

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregëtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e shoqërisë, dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga Asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

Kur Asambleja e Përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortaku ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

Neni 19

Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshperblimi

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asambleshë e shoqërisë, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

Në rastet kur shoqëria ngre padi për rastin e mesipërm përfaqësuesi i posaçëm, me anë të cilit do të marrë pjesë në gjykim, do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se ai mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara.

Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre ndaj administratorëve për ngritjen e padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 20

Të drejtat e lidhura me kuotën

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

ADMINISTRATORI

Neni 21

Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

Ortaku i vetëm apo Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë riemërimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.

Administratori të detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqesë raport të ortakut të vetëm apo të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqërisë është **Z ERKAN GURI**, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr.karte identiteti **I70608007T** lindur në Tiranë, me ditëlindje **08/06/1987** dhe banues në Tiranë Shqipëri.

Neni 22 **Përfaqësimi**

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta.

Administratori mund të nënshkruajë kontrata vetëm pasi të jenë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme/ Ortaku i vetëm.

Neni 23 **Shpërblimi**

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme.

Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregëtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 24

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të statutit dhe ligjit.
- dh) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij statuti kryejë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

KREU V ***PUNËSIMI NË SHOQËRI***

Neni 25

Zbatimi i legjislacionit të punës

Për ushtrimin e veprimtarisë së saj shoqëria ka të drejtë të marrë në punë punonjës, punësimi i të cilëve bëhet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin e punës të Republikës të Shqipërisë, në këtë statut dhe në kontratën përkatëse të punësimit.

Shoqëria ka detyrimin tu garantojë punëmarrësve kushte punë të përshtatshme, sipas kërkesës të vendit të punës, mjete të nevojshme për realizimin e detyrave, si dhe përfitimet e tjera që u garantohen prej ligjit.

Neni 26

Disiplina në punë

Punëmarrësi ka për detyrë të respektojë disiplinën në punë gjatë kohëzgjatjes të punës ose në lidhje me të.

Ortaku i vetëm/Asambleja ka të drejtë të hartojë për këtë qëllim rregulloren e brendshme të punës, e cila duhet të respektohet me përpikmëri nga të dy palët. Punëmarrësi përgjigjet për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj gjatë punës.

KREU VI

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 27

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Kjo shoqëri priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në këtë statut;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme/ Ortakut të vetëm.
- c) kur nuk mund të realizohet objekti i Shoqërisë i parashikuar në statut.
- ç) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Neni 28

Shndërrimi i shoqërisë

Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri kolektive, komandite ose anonime vetëm me vendim të Asamblesë të Përgjithshme/ Ortakut të vetëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 29

Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas parashikime të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

Për kryerjen e procesit të likuidimit, Ortaku i vetëm/ Asambleja e Përgjithshme emëron likuiduesin i cili paraqet një raport mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e përfundimit të tyre. Më përfundimin e procesit të likuidimit ortaku i vetëm për bilancin financiar përfundimtar, për rregullshmërinë e likuiduesit, për heqjen e mandatit të tij si likuidator, si dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.

KREU VII **LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**

Neni 30

Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Neni 31

Përfshirja e ortakut

Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përfshirjen e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përfshirje.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përfshirjen e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, rastet kur ortaku:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkaktonte dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkelte statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Neni 32

Pasojat e largimit dhe përjashtimit

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

DISPOZITA TË FUNDIT

Çështjet që nuk trajtohen në këtë statut, rregullohen nga legjislacioni tregëtar shqiptar në fuqi.

Tiranë , më 16/05/2023

Ortaku

ERKAN GURI

